Dardana Grabovaj ka përfunduar studimet e larta në fushën e Drejtësisë, duke u diplomuar në Master Profesional në të Drejtën Penale në Universitetin e Tiranës, si dhe në Master Shkencor në të Drejtën Publike në Universitetin Mesdhetar të Tiranës.

Me një eksperiencë profesionale mbi 12 vjet në administratën publike, që prej tetorit 2024 ajo ushtron detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Strehimit pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit. Angazhimi i saj në fushën e strehimit ka nisur në vitin 2020, fillimisht si specialiste dhe më pas si përgjegjëse sektori, ku ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në hartimin dhe rishikimin e politikave të strehimit social, si dhe të akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse. Në këtë kuadër, ajo ka mbajtur një rol aktiv në koordinimin dhe komunikimin me njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet publike dhe private, si edhe me shoqërinë civile.

Gjatë periudhës 2017–2020, znj. Grabovaj ka ushtruar funksionin e specialistes së monitorimit të agjencive në Drejtorinë e të Drejtës së Autorit pranë Ministrisë së Kulturës, duke kryer monitorimin e agjencive të administrimit kolektiv që operojnë në Republikën e Shqipërisë dhe që licencohen nga ministri përgjegjës për të drejtën e autorit.

Më herët, gjatë viteve 2013–2017, ajo ka shërbyer si inspektore në Zyrën Shqiptare për të Drejtën e Autorit, institucion në varësi të Ministrisë së Kulturës. Fokusi i punës së saj ka qenë mbrojtja e të drejtave të autorit dhe e të drejtave të lidhura me to, marrja e masave administrative, si dhe ofrimi i asistencës teknike dhe shkencore lidhur me vlerësimin e karakterit origjinal të veprave letrare, artistike dhe shkencore, me kërkesë të organeve të hetimit penal.

Paralelisht me angazhimin institucional, znj. Grabovaj është përfshirë në dhënien e leksioneve të hapura në sistemin arsimor parauniversitar dhe universitar, në kuadër të reformave për ndërgjegjësimin e të rinjve mbi të drejtat e autorit, përmes programit “Edukimi përmes Kulturës”, një prioritet i Ministrisë së Kulturës.

Në vitin 2017, Dardana Grabovaj është çertifikuar në “General Course on Intellectual Property” nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO), në bashkëpunim me WIPO Academy, Gjenevë, Zvicër.